

2024

SHTARO-Electronics SHPK

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SHTARO-Electronics” Sh. p. k.

STATUTI

EMERTIMI – OBJEKTI – SELIA – KOHEZGJATJA

NENI 1

Ne qytetin e Durrësit, sot me daten **26.08.2024** (dymije e njezet e kater) nga Ortaku i Vetem themelues:

Armand Shtaro

mbajtës i Pasaportes me nr. BF2774956, të leshuar me date 19.02.2020, e vlefshme deri më 18.02.2030. Nr.Personal: J11106057V, lindur më 06.11.1991, ne Lushnje, dhe banues ne Durrës, Shqipëri;

madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, eshte themeluar shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar “SHTARO-Electronics” SHPK.

Shoqeria “SHTARO-Electronics” është person juridik i se drejtes shqiptare, e organizuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe si e tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne perputhje me dispozitat e Statutit te shoqerise dhe ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ne perputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndërsa degët që mund te krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega që është miratuar nga ortaku themelues.

NENI 2

Shoqeria Tregetare eshte vendase dhe mban emrin “SHTARO-Electronics” Sh.p.k, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia Qendore e Shoqerise "SHTARO-Electronics" Sh.p.k eshte ne Durres ne adresen: Bulevardi Kryesor, Lagjia 11, Zona Kadastrale 8514, Durres.

NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksonin territorial te Republikes se Shqiperise.

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve mund te krijohen ose anullohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontribute ne para dhe eshte 1,500.000 (Nje milion e peseqind mijë) Lek. Ky kapital eshte i nenshkruar dhe paguar e eshte i ndare ne 1(një) kuotë me vlerë nominative 1,500.000 (Nje milion e peseqind mijë) Lek.

Ortaku themelues: Kuota zoterohet ne masen 100 % nga ortaku i vetem i shoqerise Armand Shtaro.

Ortaket me kerkese te Administratorit dhe ne perputhje me dispozitat ne fuqi te karakterit fiskal, ka te drejte te kryej pagesa apo te jape kontribute, ne kapital, ose financime ne favor te shoqerise, te cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financuar, afati i kthimit dhe menyra e rimbursimit te tyre rregullohen me kontraten perkatese. Shumat e mesiperme mund te perdoren per te mbuluar humbjet ose trasferohen direkt ne rritjen e kapitalit ne perputhje me vendimin e asamblese se ortakeve.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte PA AFAT, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e rregjistrimit te Personit Juridik ne Qendren Kombetare te Biznesit.


Me Vendim te Ortakeve kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoje, dhe ky Vendim i dergohet menjehere per depozitim Qendres Kombetare te Biznesit, kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

NENI 7

Shoqeria krijohet per te ushtruuar aktivitetin e saj tregetar si: Tregti me pakice, import-eksport, i artikujve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake, hidrosanitare e artikuj te tjere industriale. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tregtar qe nuk ndalohet me ligj.

NENI 8

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik qe nga dita e Biznesit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Ushtrimin e Aktivitetit tregetar e fillon pasi te jete rregjistruar dhe pajisur me Certifikaten NIPT nga Qendra Kombetare e Biznesit.



NENI 9

Shoqeria zhvillon veprimtarine tregetare ne perputhje me Legjislacionin shqipetar ne fuqi, si ate tregetar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore specifike per ushtrimin e saj, sipas objektit te veprimtarise se saj, si dhe mbi bazen e Aktit te Themelimit si dhe Statutin e saj.

KREU II: KUSHTET EKONOMIKE

NENI 10

Shoqeria çel Llogari Bankare ne leke vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shteterore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin finanziar te aktivitetit te saj.

Ortaket dhe Administratori Pergjithshem i caktuar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave te tyre originale ne Bankat ku eshte çelur llogaria dhe terheqja e pjeseve te saj behet kur Çeku bankar eshte firmosur nga Administratori i Shoqerise, dhe ne rastin kur Ortaket kane caktuar me shume se nje Administrator, i cili eshte jashte ortakerise.

NENI 11

Pjeset e Kapitalit Themeltar, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitive te Kodit Civil.

Ortaku ka te drejte qe te transferoj jashte territorit te Republikes Shqiperise pjeserisht apo teresisht Kontributet e saj.

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themeltar, duhet te jene te vertetuara me Kontrate Notieriale dhe per nje gje te tille Ortaket duhet te marrin paraprakisht Vendimin me shkrim, i cili ushtron efektet juridike vepruese te tij, vetem ne rast se eshte legalizuar nga nje Noter.

Shoqeria dhe te tretet, duhet te respekojne keto Transferime apo tu behen te ditura.

NENI 12


Kapitali Themeltar i Shoqerise mund te rritet ose zvogelohet, mbi bazen e Vendimit me shkrim qe merret nga ortaket, i cili nenshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bere depozitimini e tij ne Qendren Kombetare te Biznesit, e cila dhe e ka regjistruar Shoqerine Person Juridik.

KREU III: ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE, TE DREJTAT DHE DETYRAT

NENI 13

ASAMBLEJA

Asambleja e Përgjithshme është organi me i larte vendimor i shoqërisë.



Vendimet e saj merren ne përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me Statutin dhe janë te detyrueshme. Ato protokollohen ne regjistër te veçante ne përputhje me ligjin.

Asambleja ka te drejte te ushtroje ne çdo moment verifikime mbi Administratorin/et dhe te kontrolloje çdo dokument te shoqërisë. Ajo mund te urdhëroje apo te udhëzoje administratorin/et ne kryerjen e detyrës se tij.

Asambleja ka keto kompetenca:

- Vendos përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive te zhvillimit, perfshire edhe investimet kapitale;
- Vendos per ndryshimet e statutit;
- Emeron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcaktion shpërbilimet e tyre;
- Vendos per zmadhimin dhe zgjeglimin e kapitalit;
- Vendos per pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendos per transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkembimin) e pasurive te shoqerise, per cedimin apo per dhenien me qira te shoqerise ose degeve te saj, per dhenien me qera te aseteve te shoqerise;
- Vendos per miratimin e huamarrjeve me interes nga te tretet;
- Vendos per dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguruese, dorezanise etj;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel te miratuar;
- Miraton shperdarjen e fitimit, nepermjet ndarjes se dividenteve ose vendos per kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit te kapitalit;
- Miraton strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shperblimeve per çdo vend pune ne shoqeri;

Menvra e Thirrjes se Asamblese

Asambleja thirret nga Administratori/et ose nga ortaket e shoqerise, nëpërmjet një njoftimi me shkrim.

Njoftimi me shkrim duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, dhe duhet t'i dërgohet të gjithë subjekteve te interesuar, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar përmblidhjen e Asamblesë.

Megjithatë janë te vlefshme edhe mbledhjet e Asamblesë qe nuk janë thirrur si me sipër, nëse është i përfaqësuar i gjithë kapitali dhe nese ne mbledhje asiston Administratori/et dhe eksperti kontabël i miratuar (nëse ben pjesë ne strukturen se shoqerise).

Ne Asamble duhet te marrin pjesë te gjithë ata qe figurojnë te regjistruar ne librin e ortakeve.

Ortaku ka te drejtën e votës ne Asamble ne proporcion me kuotën qe zoteron ne kapitalin e shoqërisë.

Ortaku mund te përfaqësohet vete, ose nëpërmjet një personi te pajisur me prokure, i cili nuk duhet te jetë administrator, apo ekspert kontabël i autorizuar ose vartës i vete shoqërisë apo ndonjë shoqërie tjetër te kontrolluar prej saj. I takon Administratorit/ve te verifikoje te drejtën e pjesëmarrjes përmblidhje.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e përgjithshme merr vendim përvlerësimin e veprimtarisë së tij, shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij, ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria, dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

Asambleja drejtobet nga Administratori/et dhe ne mungese te tij/tyre, pjesëmarrësit ne mbledhje, me shumice absolute te kapitalit prezant ne sallë, zgjedhin një drejtues.

Asambleja emëron një sekretar edhe jashtë bashkesise se ortakeve. Sekretari imban P/verbalin e mbledhjes i cili duhet te permbaje:

- a) daten kur eshte marre vendimi;
- b) identitetin e votuesve dhe kapitalin qe ata perfaqesojne;



- a) daten kur eshte marre vendimi;
- b) identitetin e votuesve dhe kapitalin qe ata perfaqesojne;
- c) identifikimin e ortakeve pro, abstienies ose kundra;
- d) sipas kereses se ortakeve deklarimet e tyre mbi vendimin e marre;

Vendimi i Asamblesë duhet te nënshkruhet ortaku i vetem i shoqerise prezent ne mbledhje dhe ne munges te tij nga personi i autorizuar nga vete ai, si dhe nga sekretari. Kur e parashikon ligji, apo kur administratori e sheh te arsyeshme, P/Verbali i mbledhjes mbahet nga një noter i zgjedhur prej tij.

Kuorumi dhe Vendimarrja

Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te zakonshme, jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 30 për qind të kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Per Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me $\frac{1}{2}$ e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me siper, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shendrrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë;
- Shperndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;
- Percaktimi i politikes dhe mases se pagave dhe shperblimeve per edo pozicion pune ne shoqeri, duke përshtire edhe percaktimin e pages apo shperblimin e Administratorit, ekspertit kontabel te miratuar dhe likuiduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakeve qe përfaqësojnë te paktën 5% te kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçem për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

NENI 14

Ortaket kryesisht dhe me ane te Administratorit, ushtrojne dhe keto Tagra (te Drejta):

Mundesohen per te kryer te gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane te domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures te veprimtarise tregetare te Shoqerise sipas qellimeve dhe objektivave te saj siç mund te jene:

1. Te lidhin Kontrata te ndryshme qe kane per objekt Blerjen, shitjen, kembimin dhe marrjen me qera te Pasurive te ndryshme (te luajteshme dhe te paluajteshme), ate te servitutit, uzufrukutit Ensiteozes, Franchising, Sipermarrje Ndertimi, etj si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo te Huaj, me shtetin dhe ne rastin e blerjes te Pasurive te Paluajteshme apo marrjen e tyre me qera per nje kohe mbi 9 vjet, si dhe te Kontratave te Servitutit, Uzufrukutit dhe Ensiteozes, duhet te bejne rregjistrimin Hipotekat e ZVRPP te rrethit te juridiksonit perkates si per transkriptimin e Pronesise ne favor te Shoqerise apo kalimin e kesaj pasurie ne posedim ligjor.

2. Te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjitha Zyrave shteterore dhe Private, Bankat e çdo nivelit etj, qe kane te bejne me Garancite, Sipermarrjet, marrjen e Kredive, te Siguracioneve dhe Risiguracioneve per jeten dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashtë shtetit) kryerjen e

veprimeve doganore per zhdoganimin e mallrave te importuara deklarimin e atyre te eksportuar, plotesimit ne kohe dhe me rregullsi te dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

NENI 15

ADMINISTRIMI

Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohet **Z. Armand Shtaro**, mbajtës i Pasaportes me nr. BF2774956, të leshuar me date 19.02.2020, e vlefshme deri më 18.02.2030, Nr.Personal: J11106057V, lindur më 06.11.1991, ne Lushnje, dhe banues ne Durrës, Shqipëri.

Administrimi i shoqerise behet ne menyre te pavarur nga Z. Armand Shtaro. Administratori mund te veproje individualisht dhe gezon kompetenca plota.

Administratori qendrone ne kete detyre per nje periudhe kohe **5 vjet**, duke filluar ky afat nga data e nenshkrimit te ketij Statuti, me te drejte riperteritje.

Administratori gjeson kompetenca te pakufizuara për realizimin e objektit te veprimtarisë se shoqërisë, me përjashtim te atyre kompetencave qe Statuti ia njeh Asamblesë se Pergjithshme.

Administratori ka te drejten dhe detyrimin qe:

- Te kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Te zbatoje politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
- Te përfaqësoje shoqerinë tregtare perpara te treteve;
- Te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Te përgatise dhe te nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e eurisë së veprimtarisë;
- Te përgatise buxhetin vjetor te shoqerise.
- Te pregatise propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe t'i paraqese këto dokumente përpara Asamblesë për miratim;
- Te krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Te kryeje regjistrimet dhe dërgoje të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Te raportoje përpara Asamblesë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Te propozoje dhe ti paraqese Asamblese per miratim strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme, organogramen dhe rregulloren e sigurimit teknik;
- Te mos kryeje veprimtari konkuruese (ndlalimi i konkurencës) me veprimtarie qe kryen shoqeria.
- Administratori ka te drejten te rimbursohet per shpenzimet e bera per arsyet pune si dhe te drejten e nje rroge mujore te aprovuar nga Asambleja.

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut. Ai mund te vere ne lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokura ne raste gjyqesh, duke kryer operacione bankare, këtu përfshire edhe hapjen apo imballjen e llogarive



rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Ortaket dhe Administratori Shoqerise, i emeruar prej tyre, kane te drejtë qe per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te Shoqerise, te marri ne pune specialiste dhe shtetas te ndryshem madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, duke lidhur Kontraten sipas kriterieve qe parashikohen ne Kodin e Punës ne fuqi, te miratuar me Ligjin Nr.7961 dt. 12.07.1995 dhe shtesat e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin "Per Sigurimet Shoqerore" si dhe ne perputhje me rregullat teknike dhe te disiplines profesionale te caktuara nga ana e punedhentesit

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori/et eshte përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose te tretëve për shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj te tretëve, për aktivitete te kryera nga Administratori/et ne kundërshtim me kompetencat e tyre, kur vërteton se ata (te tretet) ishin ne dijeni te kësaj rrethane.

Asambleja e përgjithshme mund ti snarkojë Administratorit/et në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhene një motivacion. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV:

Pasqyrat Financiare dhe Shperndarja e Shoqerise.

NENI 16

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise, mbyllen me daten **31 Dhjetor** te çdo viti.

Hartimi i Paqyrave Financiare vjetore, behet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe publikohen brenda 6 muajve nga data e mbylljes se vitit finanziar.

Per nxjerrjen e rezultatit Kontabel te Shoqerise, mbi bazen e Aktivit dhe Pasivit, me vendim te Ortakeve caktohet një Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Eksperti ka per detyre te kontrolloje dhe verifikoje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise Ekonomiko tregetare te Shoqerise, si ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje te tille mbi bazen e Vendimit te marre nga Ortaket e Shoqerise.

Ne perfundim te Kontrollit, Eksperti kontabel i autorizuar percatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezulatit perfundimtar te Bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese dhe dorezoje ne kohe Mbledhjes se Asamblese, i cili eshte Organi i vetem per ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

NENI 17

Nxjerra e rezultateve te Pasqyrave Financiare vjetore, duhet bere me saktesi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe Ligjeve Fiskale ne fuqi, te cilat jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subjekt privat qe ushtron veprimitari tregtare.

Eksperti Kontabel i autorizuar perveç te drejtave, ka dhe keto detyrime:

1. Garanton Asamblen e Ortakeve se llogarite vjetore jane te rregullta dhe Bilanci eshte nxjerre me saktesi dhe konform rregullave te Ligjit " Mbi Kontabilitetin".

3. Te verifikoje perputhjet me llogarite vjetore te Informacioneve te dhena nga Administratori Shoqerise dhe Ortakut, duke perfshire dhe dokumentat per gjendjen financiare qe ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblese .

4. T'i beje te njojur Ortakeve dhe Administratorit te Shoqerise: Kontrolllet dhe verifikimet qe jane bere prej tij per kontolle periodike ose vjetore,duke vene ne dukje parregullsite apo pasaktesite e konstatuar,masat ligjore per rregullimin e tyre etj.

5. Eksperti Kontabel i autorizuar eshte perjegjes ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme te shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregetar te Shoqerise, por nuk eshte perjegjes kur keto DEME shkaktohen pa dijenin e tij dhe nga veprimet me faj te Administratorit te Shoqerise.

NENI 18

Pasqyrat Financiare vjetore, miratohen mbi bazen e Vendimit me shkrim te marre nga Ortaket ne Mbledhjen e Asamblese, ne te cilen jo vetem qe dokumentohet aprovimi e tyre por vendos dhe ne lidhje me disponibilitetin e Fondeve ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te Shoqerise por dhe per Garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke patur parasyesh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit te veçante etj.

NENI 19

Fitimi qe do te shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjate vitit finanziar te sapo mbyllur.

Asambleja mund te vendose për formimin e fondeve te ndryshme dhe shpërndarjen e tyre.

Asambleja pasi ka miratuar Pasqyrat Financiare përfundimtar dhe ka vendosur shumën qe do te shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për secilin ortak ne raport me kuotën qe zotëron secili.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse Administratori, nen përgjegjësinë e tij personale, lëshon një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkesat nenit 77 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"

Dividendët qe nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato.

NENI 20

Shperndarja ose Prishja e Shoqerise, mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar Shoqeria siç mund te jene:

- Humbja e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.
- Ne nje nga menyrat e parashikuara nga Ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".
- Me keresen e Ortakut Themelues.

Ne kete rast Ortaku merr Vendim me shkrim ne te cilin parashikon dhe menyren e Likudimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e Likuidatorit.



NENI 21

Akti i Umerimit te Likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon Ligji perkites duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te RBiznesit.

NENI 22

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cilave Shoqeria eshte Kreditore dhe per ekzekutimin e pote te detyrimeve (debive) qe Shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te veçante apo personave fizike ose juridik vendas apo te huaj.

NENI 23

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise mes te treteve, si rregull dhe per gjithesisht duhet te zgjidhet ne mirekuptim ne te kunderten çeshtjen mund ta bejne objekt konflikti gjyqesor, duke ngritur padi ne **Gjykatën e rrëthit Durres**.

NENI 24

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet udhezimeve plotesuese e konform aktieve ligjore e nenligjore ne fuqi, te dhena nga Ortaku vetem themelues i Shoqerise si dhe hapësirave juridike lejuese te Legjislacionit ne fuqi dhe normave nderkombetare.

NENI 25

Ky STATUT u redaktua ne 2 ekzemplare ne gjuhen shqipe dhe me permabjtje e vlera te njenja juridike dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket Themelues te Shoqerise tregetare **“SHTARO-Electronics” Sh.p. k Durres** –Shqipëri, nenshkruehet ne te gjitha ekzemplaret duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“SHTARO-Electronics” Sh. p. k.
Durres – Shqipëri

Armand Shteto
N. Shteto